



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 21 janar 2021

Njoftim për shtyp

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: dhjetor, 2020

- Në dhjetor të vitit 2020, **paraja e gjerë (agregati monetar M3^{1,2})** shënoi një rritje të konsiderueshme mujore prej 3,5%, karakteristike për këtë periudhë të vitit. Ndryshimi në rritje është si rezultat i rritjes në të gjithë komponentët, me kontribut më të madh të depozitave pa afat. Në bazë vjetore, paraja e gjerë është më e lartë për 8,3%, si rezultat i rritjes së depozitave pa afat, depozitave afatshkurtra dhe parave të gatshme në qarkullim, me një rënie të depozitave afatgjate deri më dy vjet.

Tabela 1. Totali i depozitave dhe kredive^{3,4} të sektorit joqeveritar

	sostojba (во милиони денари)						годишна промена (во %)						месечна промена (во %)	
	3.2019	6.2019	9.2019	12.2019	11.2020	12.2020	3.2019	6.2019	9.2019	12.2019	11.2020	12.2020	11.2020	12.2020
Парична маса M4	418,499	427,071	438,662	455,411	472,239	486,984	11.7	10.5	10.8	9.3	7.7	6.9	0.8	3.1
Парична маса M3	372,833	379,982	388,869	404,028	421,394	436,225	10.4	9.2	9.9	8.2	8.6	8.0	0.8	3.5
<i>од кои:</i>														
Готови пари во оптек	31,236	32,554	33,368	36,108	41,313	43,696	9.0	9.7	8.8	12.0	24.7	21.0	-1.5	5.8
Вкупни депозити	377,800	386,461	394,472	410,794	422,239	434,915	11.1	10.5	10.1	9.5	6.3	5.9	1.0	3.0
<i>од кои:</i>														
Корпоративен сектор	96,147	99,456	104,178	111,948	116,415	123,212	12.1	10.1	11.1	14.6	10.2	10.1	3.6	5.8
Во денари	66,691	71,021	75,566	81,911	81,069	86,323	11.1	13.5	11.7	17.9	8.3	5.4	3.1	6.5
Во странска валута	29,456	28,434	28,613	30,036	35,346	36,889	14.4	2.6	9.4	6.4	14.8	22.8	4.9	4.4
Домаќинства	253,748	258,100	262,458	272,605	278,896	285,216	8.7	9.0	9.3	7.9	5.4	4.6	0.4	2.3
Во денари	131,901	135,492	137,346	146,231	145,402	150,991	9.6	11.8	12.0	10.4	4.9	3.3	0.5	3.8
Во странска валута	121,847	122,609	125,113	126,374	133,494	134,225	7.7	6.0	6.4	5.2	6.1	6.2	0.3	0.5
Вкупни кредити	324,798	330,726	328,970	341,389	353,345	357,296	9.0	8.1	5.6	6.0	5.4	4.7	-0.2	1.1
<i>од кои:</i>														
Корпоративен сектор	164,734	165,305	159,764	167,952	166,659	169,826	8.2	6.4	1.7	1.9	2.5	1.1	-0.7	1.9
Во денари	103,142	103,308	99,250	103,591	100,810	102,688	10.3	8.8	3.6	-0.8	-0.1	-0.9	-1.4	1.9
Во странска валута	61,592	61,997	60,514	64,361	65,849	67,138	5.0	2.5	-1.5	6.6	6.6	4.3	0.3	2.0
Домаќинства	158,550	163,963	167,528	172,014	185,088	185,814	9.7	9.9	9.5	10.5	8.3	8.0	0.2	0.4
Во денари	88,854	91,492	92,821	95,075	105,086	105,049	12.9	11.4	9.6	10.0	11.0	10.5	0.2	0.0
Во странска валута	69,697	72,471	74,706	76,939	80,002	80,765	6.0	8.0	9.3	11.0	4.9	5.0	0.4	1.0

Burimi: BPRMV.

- Totali i depozitave⁵**, në dhjetor u rrit për 3.0% në bazë mujore, nën ndikimin e rritjes së depozitave në të dy sektorët, me një pjesëmarrje më të vogël të sektorit të korporatave.

¹Duke filluar nga qershori i vitit 2018, Banka Popullore përdor agregatin monetar M3 si një përkufizim i ri standard për parane e gjerë. Për qëllime analitike, agregati monetare M4 do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet.

²Aggregatin monetar M1 e përbëjnë paratë e gatshme në qarkullim dhe depozitat pa afat. Agregati monetar M2 është i përbërë nga agregati M1 bashkë me depozitat afatshkurtra, ndërsa agregati monetare M3 (paraja e gjerë), përveç agregatit monetar M2 i përfshin edhe depozitat me maturitet nga një deri në dy vjet. Rrjedhimisht, agregati monetar M4 përbëhet prej agregatit monetar M3 dhe depozitat afatgjate me maturitet mbi dy vjet. Për shpjegim më të hollësishëm, shihni Metodologjinë: http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_monetarna_07_2018_mak.pdf

³Normat vjetore të kredive në periudhën nga korriku 2019 këndej janë nën ndikimin e efekteve nga masat e BPRMV-së për fshirjen e kredive që janë plotësisht të mbuluara për më shumë se një vit.

⁴Të dhënat për agregatet monetare, si dhe totali i depozitave dhe kredive deri në gusht të vitit 2020, nuk i përfshijnë të dhënat për një bankë të cilës në gusht të vitit 2020 i është revokuar leja për themelim dhe punë dhe për të cilën është iniciuar një procedurë falimentimi.

⁵Totalin e depozitave e përbëjnë të gjithë depozitat e përfshirë në agregatin monetare M4.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së

Veriut

Drejtoria për Statistikë

Krahasuar në bazë vjetore, totali i depozitave është për 5,9% më i lartë, me një rritje të depozitave në të dy sektorët, që është më e shprehur në sektorin e amvisërive.

- Në dhjetor, **totali i kredive**⁶, shënoi rritje mujore prej 1,1%, e cila është kryesisht për shkak të rritjes së huadhënies për sektorin e korporatave. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, totali i kredive është për 4,7% më i lartë në kushte të kontributit më të lartë në rritjen e sektorit të „amvisërisë“.



Burimi: BPRMV.

1. Depozitat dhe kreditë e sektorit të korporatave⁷



Burimi: BPRMV.

- Në dhjetor, **totali i depozitave të sektorit të korporatave** është rritur për 5,8% në bazë mujore. Ndryshimi në rritje del kryesisht nga rritja e depozitave pa afat, me një rritje

⁶ Më 9 gusht të vitit 2018, Këshilli i Bankës Popullore e miratoi Vendimin mbi metodologjinë për administrimin e rrezikut të kredisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 149/18), sipas së cilës bankat janë të detyruara t'i transferojnë nga evidenca e bilancit në evidencë jashtë bilancit (dhe të vazhdojnë me transferimin e) të gjithë kredive që janë plotësisht të mbuluara për më shumë se një vit. Vendimi për metodologjinë e administrimit të rrezikut të kredisë filloi të zbatohet nga 1 korriku i vitit 2019, duke shterur kështu efektin e bazës së krahasimit në korrik të vitit 2020. Prandaj, ndryshimet në normat vjetore të ndryshimit të kredive me dhe pa efektin e fshirjeve të kryera janë të parëndësishme, për shkak të së cilës nga njoftimi i muajit gusht këndeje këto krahasime janë ndërprerë.

⁷Për nevojat e këtij njoftimi, sektori i korporatave i përfshin korporatat publike dhe private jo financiarë.



Veriut

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së

Drejtoria për Statistikë

më të vogël edhe në depozitat afatshkurtra dhe afatgjate në valutë të huaj dhe rënia depozitave afatshkurtra dhe afatgjate në denarë. Në bazë vjetore, depozitat janë më të larta për 10,1% si rezultat i rritjes së depozitave pa afat dhe depozitave në valutë të huaj (afatshkurtra dhe afatgjate), me një rënie të regjistruar në depozitat afatshkurtra dhe afatgjate në denarë.

- Këtë muaj, **kreditë e sektorit të korporatave**⁸ shënojnë rritje prej 1,9%, e cila me rritjen e kredive në të dy valutat, në masë të madhe është si rezultat i rritje së kredive në denarë. Duke e analizuar në bazë vjetore, kreditë e sektorit të korporatave u rritën për 1,1%, plotësisht nën ndikimin e rritjes së kredive të miratuara në valutë të huaj, me një rënie të kredive në denarë.



Burimi: BPRMV.

2. Depozitat dhe kreditë e amvisërive⁹



Burimi: BPRMV.

- Në dhjetor, **totali i depozitave të amvisërive**, u rrit për 2,3% krahasuar me muajin paraprak. Rritja është kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave pa afat, me një rritje të

⁸Duke filluar nga qershori i vitit 2018, dhe në pajtim me metodologjinë e re, të dhënat për instrumentet financiare në denarë me klauzolë valutore janë përfshirë në kuadër të valutës së huaj.

⁹Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë u referohen personave fizikë dhe personave të vetëpunësuar.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së

Veriut


Drejtoria për Statistikë

vogël në komponentët tjerë, përveç në depozitat afatgjata në denarë që shënojnë ulje. Në bazë vjetore, rritja e depozitave është 4,6% dhe është plotësisht si rezultat i depozitave më të larta pa afat dhe depozitave afatshkurtra në monedhë të huaj, me një rënie në komponentët tjerë.

- Totali i **kredive të amvisërive** këtë muaj, është më i lartë për 0,4% në bazë mujor, tërësisht për shkak të rritjes së huadhënies në valutë të huaj. Në bazë vjetore, huadhënia e amvisërive shënon rritje prej 0,8%, si rezultat i rritjes së huadhënies në të dy valutat, e cila është më e shprehur në kreditë në denarë.



Burimi: BPRMV.



Burimi: BPRMV.

Tabela 2. Kredi të bankave dhe shtëpive të kursimeve të dhëna personave fizikë, sipas qëllimit



Veriut

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së

Drejtoria për Statistikë

	sostojba (во милиони денари)						годишна промена (во %)						месечна промена (во %)	
	3.2019	6.2019	9.2019	12.2019	11.2020	12.2020	3.2019	6.2019	9.2019	12.2019	11.2020	12.2020	11.2020	12.2020
Потрошувачки кредити	82,324	86,335	89,042	92,430	98,303	98,772	10.9	12.0	12.8	14.6	7.7	6.9	0.1	0.5
Станбени кредити	46,477	47,785	49,116	51,338	57,205	58,306	13.6	12.9	11.9	12.7	13.6	13.6	1.1	1.9
Автомобилски кредити	319	320	316	316	289	282	0.4	4.0	4.8	1.4	-7.0	-10.9	2.1	-2.6
Кредитни картички	12,113	12,007	11,956	11,928	11,393	11,205	-0.4	-1.5	-2.3	-2.6	-4.8	-6.1	-1.7	-1.6
Негативни салда по тековни сметки	6,830	6,850	7,043	6,123	6,457	5,818	8.4	2.7	2.3	-1.7	-8.5	-5.0	-0.5	-9.9
Други кредити	4,252	4,217	4,194	4,118	3,861	3,871	-6.2	-8.2	-8.2	-10.6	-6.6	-6.0	-0.7	0.3

Burimi: BPRMV.

- Analizuar sipas qëllimit të kredive të miratuara për personat fizikë, në kategoritë më të zakonshme - **kreditë konsumatore dhe banesore**, është shënuar një rritje prej 0,5% dhe 1,9%, përkatësisht, si dhe një rritje vjetore prej 6,9% dhe 13,6%, përkatësisht. **Kreditë për makina** shënuan një rënie mujore dhe vjetore prej 2,6% dhe 10,9%, përkatësisht, ndërsa kreditë e miratuara në **karta të kreditit** janë më të ulëta për 1,6% dhe 6,1% në bazë mujore dhe vjetore, përkatësisht. Në dhjetor, **saldot negative në llogaritë rrjedhëse** regjistrojnë rënie mujore dhe vjetore prej 9,9% dhe 5,0%, përkatësisht. Kreditë të miratuara mbi **baza tjera** këtë muaj, janë më të larta për 0,3% krahasuar me muajin paraprak, ndërsa në bazë vjetore janë reduktuar për 6,0%.

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: Bilance dhe pasqyra të institucioneve depozituese, të dhëna mujore http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika.nspk

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_monetarna_07_2018_mak.pdf

Informacion për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesi:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf



Veriut

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së

Drejtoria për Statistikë

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimi të të dhënave

http://nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 19 shkurt i vitit 2021 (mesatare referuese deri në janar 2021).

Për pyetje gazetarësh, Ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 116 (ose 110/108).